



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT  
TË PËRGJITHSHËM DIBËR

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 47, datë 02.04.2024

**PËR MËNYRËN E FORMIMIT TË FASHIKUJVE TË GJYKIMIT DHE TË  
PROKURORIT, NË PËRFUNDIM TË HETIMEVE**

Unë **Abaz MUÇA**, Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në mbështetje të neneve 42, 46 dhe 52 të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 4 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”<sup>1</sup>, me qëllim:

- disiplinimin e mënyrës për formimin e fashikujve të gjykimit dhe të prokurorit, në përfundim të hetimeve,
- krijimin e një praktike të njehsuar për mënyrën e renditjes së akteve për të gjitha procedimet në hetim,
- sigurimin e respektimit të parimeve të një procesi të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor,

**UDHËZOJ:**

1. Në formimin e fashikullit të gjykimit të mbahen parasysh urdhërimet e nenit 332/ë të Kodit të Procedurës Penale. Në përmbajtjen e akteve të tij nuk përfshihen informacionet e policisë gjyqësore për referimin e veprës penale, urdhërat për kryerjen e veprimeve hetimore/verifikuese, deklaratimet e personave, që kanë dijeni për faktin objekt hetimi, procesverbalet e pyetjeve të të arrestuarit, të të ndaluarit dhe të të pandehurit, relacioni

<sup>1</sup> Miratuar me urdhërin nr.37, datë 25.03.2024, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

shpjegues në përfundim të hetimeve dhe në përgjithësi, çdo akt tjetër i përsëritshëm i hetimeve paraprake.

2. Të gjitha aktet, që nuk përfshihen në fashikullin e gjykimit (*origjinalet e tyre*), qëndrojnë së bashku me fashikullin/fashikujt e prokurorit (*të cilat qepen në fashikull, në fund të tij*), me qëllim për t'i përdorur gjatë gjykimit dhe që mund të shërbejnë për të bërë kundërshtimet e mundshme. Në fashikullin e prokurorit do të lidhen *fotokopje të njehsuara me origjinalin të këtyre akteve*.
3. Mënyra e renditjes së akteve në fashikullin e gjykimit, duhet të jetë si vijon:
  - Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq (kërkesa për pushimin e çështjes, vendimi për pushim e çështjes ose vendimi për pezullimin e hetimeve për procedimin penal).
  - Kopje e shkresës përcjellëse, *kur kërkesa apo vendimi dërgohen me postë*.
  - Lista e dëshmitarëve të akuzës, adresat e sakta të tyre dhe numri i celularit apo i telefonit fiks, si dhe institucioni se ku ndodhet i pandehuri në rastet kur është i arrestuar.
  - Vendimet për zgjatjet e afatit të hetimeve, në rend kronologjik.
  - Vendimet për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve.
  - Urdhëri për regjistrimin e procedimit penal.
  - Urdhëri për kryerjen e veprimeve hetimore vendoset para informacionit për referimin e veprës penale.
  - Urdhëri për regjistrimin e emrit të personit në regjistrin e veprave penale.
  - Vendimi për ndarjen e procedimeve (*në rastet kur hetimet pezullohen, ky vendim qëndron pas vendimit për pezullimin e hetimeve*).
  - Informacioni për referimin e veprës penale vendoset para materialit kallëzues.
  - Aktet që i përkasin kallëzimit të veprës penale dhe kërkesës për pranimin e padisë civile.
  - Procesverbalet e veprimeve të papërsëritshme të kryera nga policia gjyqësore dhe prokurori, ndër të tjerash sipas rastit mund të jenë edhe aktet e mëposhtme:
    - Procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes, shoqëruar nga skica dhe tabela fotografike.
    - Këqyrjet e tjera, shoqëruar nga skica dhe/ose tabela fotografike,
    - Aktet e kontrollimeve, vleftësimet e kontrollimeve, si dhe kërkesat apo vendimet e gjykatës që lejojnë kryerjen e veprimit.
    - Aktet e sekuestrimit të provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale, vendimet për vleftësimin e tyre, urdhëri për lënien në ruajtje, aktet e kthimit të sendeve të sekuestruara (*në qoftë se sendet janë kthyer gjatë hetimeve*).
    - Provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, kur nuk duhet të ruhen në vend tjetër, urdhëri për bashkimin e provave materiale me fashikullin e gjykimit.
    - Deklarimet e personave që kanë dijeni për faktin, vendosen pas sekuestrimeve, duke respektuar rendin kronologjik të veprimit. Nëse i njëjti person është pyetur disa herë, aktet të vendosen njëri pas tjetrit, në rend kronologjik.
    - Vendimet për kryerjen e ekspertimit, të pasuara nga aktet përkatëse.
  - Aktet për marrjen e masave të sigurimit.

- Kërkesat për sigurimin e provës dhe procesverbalet e veprimeve të kryera për sigurimin e provës.
  - Aktet e letërporosive nga/për autoritetet e huaja gjyqësore.
  - Dëshmia e penaltetit dhe dokumente të tjera që lidhen me personalitetin e të pandehurit.
  - Procesverbalet për veprimet e këqyrjes, njohjes dhe eksperimentit.
  - Raportet me shkrim të ekspertëve.
  - Procesverbalet e provës të procedimeve të tjera të lidhura.
  - Vendimet për lejimin e përgjimit, vendimet e vleftësimit/autorizimet e zgjatjes së tyre dhe procesverbalet e transkriptimit të bisedave dhe komunikimeve, të regjistruara,
  - Çdo akt tjetër që parashikohet në ligj.
  - Tabulatet telefonike të administruara gjatë hetimit dhe ato pjesë të përpunimit analitik të tyre, që vlejnë për të nxjerrë përfundime lidhur me faktet apo akuzat.
  - Akti i arrestimit në flagrancë (ose urdhëri i ndalimit dhe procesverbali i ekzekutimit), kërkesat për vleftësim e caktim mase, vendimi i gjykatës.
  - Procesverbali i seancës së vleftësimit (*në fotokopje të njehsuar me origjinalin*), kur i pandehuri ka qenë i pranishëm.
  - Vendimi për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës, i pasuar nga prokura e posaçme.
  - Procesverbali për pyetjen e të pandehurit.
  - Vendimi i mosgjjetjes ose kërkesa e pasuar nga deklarami i ikjes së të pandehurit.
  - Kërkesat apo memoriet e paraqitura nga mbrojtja dhe vendimet e prokurorit lidhur me to.
  - Procesverbali i njohjes së të pandehurit me aktet e hetimeve.
  - Njoftimi për përfundimin e hetimeve.
  - Relacioni shpjegues i oficerit të policisë gjyqësore.
  - Procesverbali për dokumentimin e shpenzimeve proceduriale.
4. Fotokopjet e akteve të mësipërme përfshihen në fashikullin e prokurorit, duke ruajtur të njëjtën renditje.
5. Aktet e përsëritshme, që nuk lidhen në fashikullin e prokurorit (*shih pikën 2*), do kërkohet, që të bëhen pjesë e fashikullit të gjykimit vetëm në rastet kur do procedohet me gjykimin e posaçëm atë të shkurtuar, pikërisht në momentin kur prokurori i seancës krahas qëndrimit të tij për pranimin ose jo të gjykimit të shkurtuar, do informojë gjykatën se gjatë hetimeve janë administruar edhe aktet e mësipërme, të cilat do ia dorëzojë gjykatës (sipas parashikimeve të nenit 403 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, si dhe vendimit unifikues nr.2, të vitit 2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).
6. Aktet renditen nga oficeri i policisë gjyqësore i deleguar dhe kontrollohen nga prokurori.

7. Pas renditjes së akteve si më sipër, të dy fashikujt i paraqiten drejtuesit për siglim. Pas siglimit, prokurori i çështjes plotëson kartelën përkatëse dhe ia dorëzon sekretarisë për të bërë lidhjen e tyre. Sekretaria formulon shkresat përcjellëse për gjykatën ose për Drejtorinë Vendore të Policisë përkatëse, në rastin e pezullimit të hetimeve.
8. Fashikujt e formuar si më sipër, pas lidhjes së tyre, sekretaria ia ripërcjell drejtuesit të prokurorisë.
9. Për çështjet që dërgohen në gjyq, fashikulli i hetimeve paraprake (*kopertina e të cilit do jetë e ndryshme në ngjyrë nga ajo e gjykatës*) mbahet nga prokurori deri në përfundim të gjykimit.
10. Ngarkohet zyra e financës dhe kryesekretarja, që të marrin masat për blerjen e kapakëve të dosjeve.
11. Pas përfundimit të gjykimit, prokurori plotëson rubrikat në pjesën e pasme të kapakut, plotëson kartelën, vendos konkluzionet përfundimtare në fund të akteve dhe ia paraqet dosjen drejtuesit për siglim, jo më vonë se 3 ditë nga data e dhënies së vendimit. Në rastin kur vendimi apelohe, ky afat është 5 ditë. Akti i apelimit vendoset në fashikull pas konkluzioneve përfundimtare.
12. Pas nënshkrimit nga drejtuesi fashikulli depozitohet në sekretari, ku kryhen shënimet përkatëse në regjistër dhe arkivohet.
13. Në rastin kur vendimi apelohe, sekretaria kryen brenda ditës praktikën e dërgimit të akteve.
14. Të njihen me këtë urdhër të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, kryesekretarja dhe sekretaria e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
15. Mosrespektimi i këtij udhëzimi përbën shkelje të natyrës disiplinore.
16. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe depozitimit në sekretari dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

